

Si shqiptarë të pandreqshëm dhe të pakorigjueshëm, ishim dërguar në rrethin e fundit të ferrit, edhe pse ende nuk ishim takuar me vdekjen. Një ferr i vërtetë, një ferr jo nën tokë por mbi të, i krijuar jo nga ndonjë forcë e mbinatyrshe, që është e pa perceptueshme nga mendja e qenieve njerëzore, por nga vetë 'njerëzit' për njerëzit. Nga nazistët. Disa qenie me pamje njeriu të cilat pretendonin se forconin zjarrin e superioritetit të rracës së tyre duke vjedhur flakën e shpirtave të lirë, në ferrin që ata e quanin kamp.

Jashtë i ftohti i natës gjithnjë mprehte thika. Orë nuk kishte. Koncepti kohës aty merrte trajta të reja, dukej sikur zgjatej, zvarritej, ngadalësonte, priste e ndonjëherë dhe ndalonte fare. Dukej sikur nazistët përveç jetëve tona në dorë kishin dhe vetë kohën. Por mund të kuptohej se rrezja e parë e diellit ende nuk kishte çarë hapësirat e qiellit. Në fakt rrezja e diellit nuk vinte kurrë aty. Ishte gjithmonë natë. Ndoshta ky fakt vinte si pasojë e masdëshirës së diellit për të ndrrirë mbi atë vend çnjerëzor ose ndoshta lidhej me faktin se tubat e krematoriumit që furnizonin qiellin me re të zeza, nuk kishin të pushuar në asnjë moment të ditës.

Ishte dita dhjetë në atë ferr. Meqenëse ishte dimër dhe disave prej nesh i ishte caktuar të punonin në gurare, zgjoheshim gjithnjë në orën 07:15, zgjim që shoqërohej me tingujt e shqiptimit në mënyrë perfekte të numrave në gjuhën gjermane (të përcaktuar prej tyre që ditën e parë). Ndërsa shqiptarët e mbetur u detyruan të bënin punë të tjera dhe shumica u nda nëpër filialet e këtij ferri. Koha e gjumit ishte shumë e shkurtër për t'u rigjeneruar nga tortura shumë orë ditore. Madje shpesh na terrorizonin në mes të atij gjumi të pakët (që sipas rregullave e ndoja me dikë tjetër në shtrat) me kontrollet strikte për pastërtinë në baraket tona. Ishin po kta nazistë që jepnin dënime ekstreme në rast shkelje të rregullave të pastërtisë, të cilët nuk na falnin as sa çikërrima kohe për të pritur në rradhët e dendura, që të laheshim gjatë javës.

Atje ku unë punoja (një nga kurthet e shumta për të dërguar afër vdekjes) ngrinim e zbrisim blloqe të rënda graniti. Kjo punë nuk kishte asnjë qëllim të përcaktuar, ishte e pakuptimtë dhe kryhej vetëm si një formë torture me orë të gjata (konkretisht 8-10 orë pa përfshirë kohën që merrte rruga), me shpresën se dikush do mposhtej nga pesha e blloqeve e nga rrëzimi do merrte me vete dhe jetën e shumë të tjerëve.

Të tjerë punonin në "shkëmbin e parashutistëve" ku gërmonin në mal për të hapur tunele, fundi i të cilëve nuk të dërgonte askund, përveç vdekjes. Prej lartësive të këtij shkëmbi, shpesh nazistët hidhnin pa asnjë arsye të burgosur. Ndërsa të tjerë u përdornin në industrinë e armatimit, në ndërtimin e bunkerëve, prodhimin e çimentos ose dhe në krematorium. Pasi na torturonin me orë të tëra ktheheshim sërish në kampin e vdekjes. Sa më shumë afroheshim aq më i zi bëhej qielli prej frymës së zezë së krematoriumit. Aty digjnin me mijëra njerëz, të cilët konsideroheshin nga nazistët si të sëmurë e afër vdekjes, por ai zjarr gllabëronte të rinj, burra e gra shtatëzana që ishin shëndoshë e mirë, sidomos ato me kombësi hebreje që kishin një jetëgjatësi mesatare prej 2-3 javësh.

Vetëm të qenit dëshmitar i këtyre makabriteteve të shkatërronte, sidomos ne shqiptarëve. Nuk kishim një grimcëz mbështetje e një sup shqiptar afër nesh. Të gjithë të burgosurit në kamp kishin një bllok të veçantë në varësi të kombësisë së tyre, ndërsa ne bënim përjashtim, shqiptarët ishin të ndarë si zogj korbi. Kjo na vriste jashtë mase e na e dobësonte jashtë mase shpresën për një të ardhme larg këtij vendi, na i kryste gjithnjë e më shumë ëndrrat për një kthim në atdheun tonë.

Nazistët ja kishin frikën disa figurave shqiptare, të cilët ndodhenin brenda kampit si Kozma Nushi, Telat Noga, Enver Velja etj. Madje i kishin shpallur dhe si njerëz të rrezikshëm. Ndoshta kjo ishte arsyeja që na kishin shpërndarë të gjithëve andej-këndej. Përmes informacioneve që merrnim, arritëm të kuptojmë se numërimi ynë (përmes numrave matrikullë që i mbanim në tri vende në uniformën me riga bardhë e blu, ndjekur nga ylli blu) fillonte nga 99760 deri në 100071. Kjo nënkuptonte se gjithsej ishin 311 shqiptarë, por më vonë u informuam që në kamp kishin qenë dhe 25 shqiptarë të tjerë para nesh, të cilët me shumë mundësi ishin ekzekutuar pasi nuk gjendeshin më aty.

Këto i mësonim duke shfrytëzuar pushimin që kishim në kamp, pas torturës së përditshme, kohë përgjatë së cilës na jepnin dhe për të 'ngrënë'. Por a të ushqen vallë, ai që do të të vrasë? Shumicën e rasteve nuk lanim dot as duart, pasi mund ta vidhnin ushqimin ose ta derdhte kapoja në varësi të humorit. Ushqim?! Ushqim e quanin ato. Hanim me gramatura aq të vogla sa rënia ekstreme në peshë për punë ditësh bënte kuptim. Ishim si të vdekur që nuk kishim shkuar në botën tjetër. Kockat për pak dalloheshin me sy të lirë. Ngaqë kockat dukeshin sikur dëshironin të dilnin jashtë, ishim bërë si figura me pafund kulme. Gjenim tela për të lidhur pantallonat në vend të rripit prej lëkure, pasi trupat na zvogëlloheshin. Ndoj na mbeste të shkonim fshehurazi nëpër kazanë, që të hanim ndonjë lëkurë patateje apo qymyr të djegur se na kujtonte çokollatën, por shpeshherë edhe gjethe.

Nazistët të sëmurin me qëllim e më pas si i sëmurë që ishe të dërgonin në krematorium, për t'u djegur dhe nga njerëz të pafajshëm, që nga frika se mos vriteshin, shndërroheshin në vrasës. Çdo funksion, strukturë, rregull dhe ushtar i kampit përbënte një sinonim të fjalës 'vras'. Aq shumë të burgosur vrisnin saqë dhe vetë kaldaistët nuk i dilte koha për pushim gjatë gjithë ditës. Për këtë arsye nazistët shtuan numrin e njerëzve për një djegje, nga gjashtë në dhjetë. Në fund të fundit vdekja i priste?! Stefan Konduri punonte aty. Nazistët e bënë vrasës. Edhe të tjerë shqiptarë i bënë vrasës, madje vëllavrasës. Vangjel Doni varrosi Hilo Nako-n për së gjalli, pasi ai nuk mund të duronte dot më torturën. Nazistët ndryshuan dhe konceptin për vdekjen, por ta ishte argëtim. I shoqëronin të dënuarit me varje në litar drejt vdekjes me orkestër. Vdekja ishte një shpëtim për pjesën më të madhe të njerëzve, vdekja ishte një parajsë krahasuar me mizorinë që po kalonim në çdo moment. Ndërsa për banorët e fshatit pranë kampit (që ishin mjaft mirë në dijeni të çdogjëje që ndodhte brenda), vrasja masive përmes djegjes e torturave çnjerëzore, ishte diçka normale dhe nuk gëzonte aq rëndësi të madhe sa të fitonte vëmendjen, as sa për një copëz të vogël kurioziteti.

Vuajtëm shumë, vuajtëm shumë! U kthyem në skeletë, pa shpresë, pa guxim, në njerëz që ngjanin më shumë me sendet e pajetë se me qeniet njerëzore. Vdekja ishte miku ynë i përditshëm dhe mendimi ynë i parë në çdo moment. Na vodhën, na vodhën gjithçka, familjen, të afërmit, lirinë, kohën, lumturinë, pafajësinë, bardhësinë, dëshirën për t'u përfshirë sërish me botën prej së cilës na ndanë. Na vodhën mundësinë që të nderonim vëllezërit që ranë viktimë e atij ferri. 323 shqiptarë e përjetuan atë ferr teksa 300 prej tyre lanë kockat në themelet e tij. Shumë prej nesh ikën nga kjo botë sikur mos të kishin ekzistuar kurrë. Pa emër, pa vit, pa varr, por thjesht si numra.

U burgosëm teksa luftonim për lirinë. Sakrifikuam që shqiptarët të jetonin në një Shqipëri të lirë, por shumica jonë, që në atdhe të shkelte, s'e kish më mundësinë. Jetuam në atë ferr me shpresën se rruga drejt parajsës kalonte përmes tij (siç Dante Aligeri shpreh), por parajsa nuk erdhi kurrë tek ne. Besimi në ekzistencën e saj u shua gjithnjë e më shumë teksa ditët shtoheshin në atë ferr. Tani as nuk besoj më në ekzistencën e saj. Besoj veç në ferr. Rezistua, me besimin e madh se një ditë do të ishim të lirë, por dhe unë që e mposhta atë ferr, sot nuk ndihem më i tillë.

PUNOI: RIGERS BUDLLA

+355688378872